

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERI V.MARTINI

Nr. 1702 regj.

Nr. 593 kol.



KONTRATE SHITJE

Prq 1702

Sot, me date 07.09.2002, ne Lezhe para meje noter Vasil Martini u paraqiten palet:

1. Armando Bonetti, lindur ne Parma Itali me 25.09.1939 dhe banues ne Miliano per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta qe mbante me vete dhe nga njohja ime personale, me cilesine e pales shitesse.

2. Zef Shtjefni i datelindjes 10.04.1960, lindur dhe banues ne Lezhe per identitetin e te cilit u sigurava nga njohja ime personale, me cilesine e pales blerese.

Te dyja palet kerkuan nga une noteri redaktimin e tekstit te meposhtem te kesaj kontrate: Armando Bonetti posedon 60% (gjashtedhete perqind) te kuotave te sh.p.k MILIS (Fabrika e tullave Lezhe), c'ka vertetohet me statutin e shoqerise ne fjale dhe vendimin e Gjykates se Tiranes nr.3193/2 dt.27.09.2000. Keto kuota totalisht permes kontrates se premtimit te shitjes te dates 27.07.2000 pika 2, Armando Bonetti ia ka shitur ortakut te vet Zef Shtjefni, baraz me 21.000.000 lek.

Armando Bonetti deklaroi se eshte likujduar totalisht nga Zef Shtjefni per cmimin e rene dakord dhe me kete akt largohet perfundimisht nga sh.p.k Milis, duke ia kaluar totalin e 60% te pronesise se kuotave te tij, Zef Shtjefnit. Ne kete menyre Zef Shtjefni qe ne kete moment zoteron 100% (njeqind per qind) te kuotave te Milis sh.p.k, e cila posedon Fabriken e tullave Lezhe.

Zef Shtjefni gjithashtu deklaroi se e ka pranuar dhe likujduar teresisht cmimin e rene dakord me Armando Bonettin ne perputhje te plote me kontraten e dt.27.07.2000 te firmosur me deshiren reciproke te te dyja paleve.

Te dyta palet deklarojne se cdo gje e kane bere me vullnetin e tyre te lire dhe konform statutit te shoqerise dhe ligjeve shqiptare ne fuqi, c'ka konfirmohet edhe nga une noteri. Per vertetimin e sa me siper, ftova palet ne prezencen time te nenshkruajne kete kontrate si me poshte.

PER PALEN SHITSESE

Armando Bonetti

PER PALEN BLERESE

Zef Shtjefni

NOTERI
VASIL MARTINI